

Statuti i Shoqërise tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar,(shpk)

"OSS Service International"

Në këtë statut

- **"Ligji"** është Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- **"Statuti"** është Statuti i shoqërisë.

Kreu I – Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1 – Data e themelimit, emri dhe themeluesit


1. Sot, më 26.05.2025, ne, themeluesit, krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "OSS Service International" SH.P.K.
2. Themeluesit e shoqërisë janë:
 - Demir Jahja me shtetësi shqiptare , resident ne Itali, I paisur me pashaporte Nr ID I70927089G.
 - Alberto Poma me shtetësi Italiane, resident ne Rumani, I paisur me pashaporte Nr ID YC0015068.

Neni 2 – Objekti

Shoqëria do të ushtrojë këto aktivitete kryesore:

1. **Ofrimin e shërbimeve të kujdesit në shtëpi** (home-care) për persona të moshuar;
2. **Asistencë, përkujdesje dhe rehabilitim** për persona me paaftësi fizike ose mendore që nuk mund të vetë-kujdesen;
3. Organizimin e **aktiviteteve sociale, edukative e terapeutike** për kategoritë e mësipërme;
4. Çdo veprimtari ndihmëse ose plotësuese në fushën e kujdesit social e shëndetësor, të lejuar nga legjislacioni shqiptar.

Shoqëria mund të ndryshojë ose zgjerojë objektin me vendim të Asamblesë së Ortakëve dhe pas pasqyrimit në QKB .



Neni 3 – Kohëzgjatja

Shoqëria do të ketë kohëzgjatje 1 pakufizuar.

Neni 4 – Selia

Selia është në adresën: : *Elbasan, Lagja 28 Nëntori, ndërtesa nr 109/1, zona kadastrale 8523, nr pasurie 8/371-n.8, kodi 3001*. Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

Kreu II – Kapitali

Neni 5 – Kapitali themeltar

1. Kapitali fillestar është 100.000 lekë.

- Ortaku Demir Jahja: posedon 1 kuotë me vlerë 50.000 lek (50 %)
- Ortaku Alberto Poma: posedon 1 kuotë me vlerë 50.000 leke(50 %) Kontributet jane ne para.

Neni 6 – Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- Zmadhimi bëhet me kontribute në para/natyrë; asnjë ortak nuk detyrohet të rrisë kuotën pa pëlqimin e tij.
- Zvogëlimi lejohet me vendim të asamblesë në të njëjtat kushte si ndryshimi i statutit; prek të gjithë ortakët proporcionalisht.

Neni 7 – Transferimi i kapitalit

Kuotat mund të transferohen përmes:

a) kontributit; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyre tjetër ligjore.

Kuotat janë lirisht të transferueshme mes ortakëve dhe trashëgimtarëve, përveç ndrysheparashikimit në statut.



Kreu III – Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Neni 8 – Organi vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës dhe vendos, ndër të tjera, për:

- politikat tregtare;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin/shkarkimin e administratorëve, likuiduesve, ekspertëve;
- miratimin e pasqyrave financiare;
- zmadhimin/zvogëlimin e kapitalit;
- riorganizimin ose prishjen e shoqërisë;
- çështje të tjera ligjore ose statutare.

Neni 9 – Thirrja e asamblesë

Asambleja thirret me shkresë ose e-mail, duke njoftuar vendin, datën, orën dhe rendin e ditës jo më vonë se 7 ditë para mbledhjes. Vendimet janë të vlefshme edhe pa thirrje formale nëse të gjithë ortakët bien dakord.

Neni 10 – Kuorumi


- Për shumicë të zakonshme: të jenë të pranishëm ortakë që zotërojnë > 30 % të kuotave.
- Për shumicë të kualifikuar (neni 87, Ligji 9901): duhet prania > 50 % e votave.

Neni 11 – Marrja e vendimeve

- $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës për: ndryshim statuti, zmadhim/zvogëlim kapitali, shpërndarje fitimi, riorganizim, prishje.
- Shumicë e thjeshtë për çështjet e tjera.

Neni 12 – Përjashtimi nga e drejta e votes

Ortakët nuk votojnë kur vendimi lidhet me: vlerësimin e veprimtarisë së tyre, shuarjen e detyrimeve të tyre, paditë ndaj tyre, ose përfitime të reja.

Two handwritten signatures in black ink are located in the bottom right corner of the page. The top signature is a stylized, somewhat abstract mark, while the bottom signature is more legible, appearing to read 'Dau H'.

Administrimi

Neni 13 – Administratori

- Emërohet nga asambleja për 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, efekt pas regjistrimit në QKB.
- Të dhënat e administratorëve:

Administrator I shoqërisë caktohet zoti Demir Jahja me mandat për 5 vjet.

Neni 14 – Kompetencat e administratorit

- a) Kryen veprimet e administrimit;
- b) Përfaqëson shoqërinë;
- c) Mban dokumentet dhe librat kontabël;
- ç) Përgatit dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore;
- d) Krijon sistem paralajmërimi për rrezikun financiar;
- dh) Kryen regjistrimet në QKB;
- e) Raporton para asamblesë;
- ë) Çdo detyrë tjetër ligjore/statutare.

Neni 15 – Përgjegjësitë

Administratori përgjigjet individualisht për shkelje të ligjit, statutit ose faj gjatë administrimit, përfshirë detyrimin për dëmshpërblim të shoqërisë.

Kreu IV – Viti financiar dhe ekspertët

Neni 16 – Viti financiar

Fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor. Viti i parë fillon nga data e regjistrimit në QKB.

Neni 17 – Ekspertët

Eksperti kontabël autorizuar kontrollon dokumentacionin, harton raport financiar dhe ia paraqet ortakëve për miratim.



Kreu V – Prishja dhe riorganizimi

Neni 18 – Prishja/Likuidimi

Shoqëria shpërndahe kur:

- a) mbaron afati; b) vendim asambleje; c) hapje falimenti; ç) mungesë aktiviteti për 2 vite;
- d) vendim gjykate.

Asambleja cakton likuiduesit dhe procedurat.

Neni 19 – Riorganizimi (bashkim/ndarje)

Sipas vendimit të asamblesë dhe dispozitave të Pjesës IX, Ligji 9901.

Kreu VI – Dispozita të përgjithshme

Neni 20 – Baza ligjore


Shoqëria vepron në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin shqiptar. Për çfarë nuk parashikohet, zbatohen dispozitat e Ligjit 9901, Kodit Civil etj.

Neni 21 – Mosmarrëveshjet

Për çdo mosmarrëveshje kompetente është Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT

Demir Jahja



Alberto Poma

